



This project is funded by
the European Union



MNE-KOS

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-KOSOVO 2014-2020

Konferenca përfundimtare e Programit IPA I të Bashkëpunimit Ndër-kufitar Mali i Zi – Kosovë 2011 – 2013

RAPORT

Qëllimi: Qëllimi i kësaj Konference Përfundimtare ishte të prezantojë tek publiku i gjerë ndikimin që programi ka pasur për komunitetin e zonës së programeve në mënyrë që të përmirësojë cilësinë e jetës së tyre, si dhe të ndajnë historitë e suksesshme të projekteve të zbatuara dhe për të promovuar bashkëpunim të mirë ndërkufitar në mes të përfituesve në kuadër të mbështetjes financiare nga Bashkimi Evropian përmes IPA I të Programit të bashkëpunimit ndër-kufitar Mali i Zi-Kosovë 2011-2013. Për më tepër, qëllimi i konferencës ishte ofrimi i informacionit të detajuar për pjesëmarrësit dhe publikun e gjerë mbi Programin e mëparshëm të IPA I të bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi - Kosovë 2011-2013 dhe rezultatet e arritura përmes zbatimit të aktiviteteve në kuadër të projekteve të mbështetura nga Bashkimi Evropian në perspektivën e mëparshme financiare.

Data: 19 janar 2018

Vendi: Hoteli Centre Ville, Podgoricë, Mali i Zi

Pjesëmarrësit: Z. Aleksandar Andrija Pejović, Ministër për Çështje Evropiane i Malit të Zi (MÇE), Z. Beqir Fejzullahu, Zëvendësministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Z. Hermann Spitz, Shef i Sektorit të Bashkëpunimit në Delegacionin e Bashkimit Evropian në Malin e Zi (DBE MZ), përfaqësues të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Mal të Zi, Përfaqësuesit e SO MZ, Përfaqësuesit e SO KS, anëtarët e KPM-së nga të dy vendet përfituese, përfaqësuesit e organizatave përfituese nga Mali i Zi dhe Kosova, përfaqësuesit e komunave nga MZ dhe KS, përfaqësuesit e ndërmarrjeve publike dhe institucioneve shtetërore, përfaqësuesit e sektorit civil nga MZ dhe KS, përfaqësuesit e medias nga MZ dhe KS, stafi i SPT, etj. (Ju lutemi shihni Shtojcën 1 - lista e pjesëmarrësve).

Tema:

Konferenca përfundimtare e Programit IPA I të bashkëpunimit ndër-kufitar Mali i Zi – Kosovë 2011 – 2013 u organizua në Podgoricë nga Ministria për Çështje Evropiane të Malit të Zi në bashkëpunim të ngushtë me ministrinë e saj homologe nga Kosova, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës, ku u prezantuan projektet e zbatuara në kuadër të Programit, arritjet dhe rezultatet e aktiviteteve të zbatuara brenda këtij programi. Për më tepër, është paraqitur në detaje efekti i përgjithshëm në fushën e programit të projekteve të financuara në kuadër të THP të parë brenda këtij Programi.



This project is funded by
the European Union



MNE-KOS

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-KOSOVO 2014-2020

Audienca pati mundësinë të informohet për gjithsej 9 projekte që janë zbatuar brenda këtij programi. Përveç kësaj, statistikën dhe rezultatet e zbatimit të programit u paraqitën në detaje si dhe informacione mbi programin e ri të IPA-s, bashkëpunimi ndër-kufitar Mali i Zi – Kosovë 2014-2020.

Për të komunikuar arritjen e rezultateve të programit me publikun më të gjerë, ftesat për të marrë pjesë në konferencën përfundimtare u dërguan përfaqësuesve të strukturave operative në të dy vendet, përfaqësuesit e institucioneve relevante në Malin e Zi dhe në Kosovë, komunitetet e zonës së programit, përfituesit e projektit të Programit BNK MZ-KOS 2011-2013, aplikantët potencialë të Programit BNK MZ-KOS 2014-2020, organizatat joqeveritare dhe mediat nga të dy anët e kufijve.



Konferenca u vijua nga 83 pjesëmarrës të cilët patën mundësinë të njihen me të arriturat dhe rezultatet e projektit të Programit të IPAs Bashkëpunimi Ndërkufitar Mali i Zi - Kosovë 2011-2013. Në konferencë morën pjesë përfaqësues të ministrive malazeze dhe të Kosovës, kryetarët e komunave, përfaqësuesit e institucioneve lokale dhe shtetërore, ndërmarrjet publike, përfituesit e projektit, përfaqësuesit e mediave malazeze dhe kosovare dhe shoqërisë civile.




This project is funded by
the European Union



MNE-KOS

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-KOSOVO 2014-2020



Grafiku 1 – Struktura e pjesëmarrësve në konferencë

Domethënë, 37% e pjesëmarrësve të konferencës ishin zyrtarë të lartë të Ministrive për Çështje Evropiane në Malin e Zi dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal në Kosovë, si dhe përfaqësues të ministrive dhe institucioneve të tjera shtetërore nga Mali i Zi dhe Kosova. Komunitat nga të dyja anët e kufirit shprehën interesin e tyre, të cilët përbënin 12% të pjesëmarrësve, duke përfshirë kryetarët e komunave të Podgoricës, Petnjica, Plavës, Gusisë (MZ) dhe Klines (KOS). 9% e pjesëmarrësve ishin përfaqësues të përfituesve të projektit të fundit, nga të cilët katër prej tyre morën pjesë në panel diskutimi në sesionin e fundit të konferencës. Organizatat joqeveritare treguan interes të sinqertë lidhur me azhurnimin e rezultatit të Programit të mëparshëm IPA I për Bashkëpunim Ndërkufitar Mali i Zi - Kosovë 2011-2013, duke paraqitur 7% të pjesëmarrësve. Në anën tjetër, ngjarja u vijua nga 35% e pjesëmarrësve që nuk ishin përfshirë në këto kategori, si aplikantët potencialë, ndërmarrjet shtetërore dhe lokale publike, si dhe organizatat e shoqërisë civile nga Mali i Zi dhe Kosova dhe palët e tjera të interesuara. Delegacioni i Bashkimit Evropian në Mal të Zi u drejtua nga Shefi i sektorit të bashkëpunimit z. Hermann Spitz, i cili u shoqërua nga Task Menaxherët dhe konsulentët e Programeve të BNK.



This project is funded by
the European Union



MNE-KOS

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-KOSOVO 2014-2020



Konferenca u organizua në formë (sistem) të trefishtë.

Në fillim fjalimet hyrëse u mbajtën nga Ministri për Çështje Evropiane të Malit të Zi, Z. Aleksandar Andrija Pejović, Zëvendësministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal i Republikës së Kosovës, Z. Beqir Fejzullahu dhe Shefi i Seksionit të Bashkëpunimit në Delegacionin e Bashkimit Evropian në Mal të Zi, z. Hermann Spitz.

Z. Aleksandar Andrija Pejović, Ministër i Çështjeve Evropiane të Malit të Zi shprehu kënaqësinë e tij me faktin se rezultatet konkrete dhe të dukshme të projekteve të zbatuara nën PBNK Malin e Zi - Kosovë 2011-2013, kanë kontribuar në zhvillimin gjithëpërfshirës të zonës kufitare dhe konfirmuan suksesin e konceptit të bashkëpunimit ndërkufitar. Ai rikujtoi se në kuadrin e Programit të



Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi-Kosovë 2011-2013 janë financuar dhe zbatuar nëntë projekte, në shumën totale prej 3.7 milion euro dhe se qëndrueshmëria e tyre është e dukshme edhe pas mbylljes formale të projekteve. Rezultatet e projektit kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në mbrojtjen dhe menaxhimin e burimeve ujore, krijimin e modeleve unike turistike dhe përfshirjen sociale të grupeve të cënueshme, sidomos të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Prandaj,

këto projekte kanë kontribuar në arritjen e objektivave të programit që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik, mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e biodiversitetit, promovimin e burimeve të përbashkëta natyrore në kufi, si bujqësia, pylltaria dhe zhvillimi i turizmit.



This project is funded by
the European Union



MNE-KOS

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-KOSOVO 2014-2020

Ai gjithashtu deklaroi se edhe pse ky ishte financiarisht Programi më i vogël dhe që filloi i fundit, ky program hodhi themelet për bashkëpunimin e ardhshëm dhe i lidhi përfituesit dhe palët e tjera të interesit në zonën kufitare. Duke pasur rezultate të shkëlqyera nga programi i përfunduar, siç vuri në dukje Pejoviç, ne arritëm të bëjmë thirrjen e parë në kuadër të këtij programi të ri Mali i Zi-Kosovë 2014-2020 në mesin e të parëve, prandaj së shpejti do të kemi një ceremoni të dhënies së kontratës. Ai njoftoi se për periudhën e ardhshme 2014-2020, pothuajse tre herë më shumë, ose 10 milionë euro janë ndarë për bashkëpunimin midis Malit të Zi dhe Kosovës.

Z. Beqir Fejzullahu, zëvendësministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në fjalën e tij theksoi se "me zbatimin e suksesshëm të këtyre projekteve, të dy vendet kanë dëshmuar të jenë të suksesshëm, në zbatimin e programit të BNK IPA I (2011-2013) si dhe arritjen e objektivave të përgjithshme të programit". Ai nënkuptoi se përmes zbatimit të këtyre projekteve, stimulohen turizmi malor dhe rural, duke arritur të tërheqin vizitorë vendas, rajonalë dhe ndërkombëtarë, ndërkohë që infrastruktura e eko-produkteve të prodhuesve lokal është krijuar duke ndërtuar kapacitetin e tyre, gjë që ka çuar në rritjen ekonomike lokale. Është rritur vetëdija në lidhje me mbrojtjen e burimeve



opsionale të energjisë, resurseve ujore, mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e duhur të NVM-ve, si dhe përfshirjen e anëtarëve të komuniteteve RAE në institucionet arsimore. Janë fuqizuar kapacitetet e organizatave të shoqërisë civile si dhe fushata e ndërgjegjësimit.

Ndër të tjera, z. Fejzullahu theksoi faktin se, me ndihmën e fondeve të IPAs për programin e BNK-së, Kosova ka bërë përparim të konsiderueshëm në ekonominë e saj, si një nga prioritetet më të rëndësishme të vendit. Programi i BNK-së Mali i Zi - Kosovë u vlerësua shumë nga përfaqësuesit e të dy shteteve, si dhe nga delegacioni i BE-së në Mal të Zi. Gjithashtu, arritjet reciproke midis dy shteteve kanë forcuar bashkëpunimin dhe partneritetin për programet e ardhshme të bashkëpunimit ndërkufitar.

Së fundi, z. Fejzullahu i siguroi pjesëmarrësit se MAPL do të vazhdojë të mbetet plotësisht e zotuar për të siguruar një zbatim të suksesshëm të Programit IPA II të BNK ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi (2014-2020).



This project is funded by
the European Union



MNE-KOS

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-KOSOVO 2014-2020

Shefi i Sektorit të Bashkëpunimit në Delegacionin e Bashkimit Evropian në Mal të Zi, z. Hermann Spitz, theksoi se zbatimi i Programit IPA I i BNK-së Kosovë-Mali i Zi 2011-2013 kontribuoi në përmirësimin e cilësisë së jetës në zonën kufitare përmes mbështetjes së projektit. Ai vuri në dukje se 9 projekte të zbatuara jo vetëm që kontribuan në zhvillim, por edhe promovuan vlera të përbashkëta



evropiane, siç janë respektimi dhe bashkëpunimi i ndërsjellë. Z. Spitz tha se brezi i ri i programeve, i cili filloi në vitin 2016, solli sfida të reja, por gjithashtu thjeshtoi procedurat, si një buxhet unik i programit, një kontratë unike të granteve për një projekt dhe krijimin e një autoriteti të vetëm kontraktues. E gjithë kjo, shtoi ai, ka shkaktuar më shumë përgjegjësi të shteteve, veçanërisht të Malit të Zi, i cili është partneri kryesor në program.

Në pjesën e dytë të konferencës, Zyrtari i Projektit i SPT, Z. Nikola Djonovic ka prezantuar shkurtimisht programin e mëparshëm dhe aspektet teknike përkatëse, duke informuar publikun edhe për Programin e ri të Bashkëpunimit



Ndërkufitar IPA II - Mali i Zi - Kosovë 2014-2020. Pas informacioneve rreth fazës aktuale të Programit të ri, u paraqitën nëntë (9) projekte të zbatuara në kuadër të IPA I të PBNK Kosovë-Mali i Zi 2011-2013, duke përfshirë aktivitetet dhe arritjet kryesore. Projektet që janë financuar në kuadër të perspektivës së mëparshme financiare (MZ-KS 2011-2013) janë si në vijim:

1. "Nëpërmjet majave të Alpeve Dinarike" zbatuar nga QITQ në Mal të Zi në bashkëpunim me Fondin për Zhvillimin e Komunitetit nga Kosova, me qëllim të zhvillimit të rrjetit të rrugëve alpiniste - ViP Dinarica dhe ngritjes së vetëdijes mbi përfitimet ekonomike, mjedisore dhe sociale të shtigjeve të distancave të gjata dhe paketës turistike nëpërmjet valorizimit të pasurisë unike natyrore dhe trashëgimisë kulturore-historike.
2. "Përmirësimi i menaxhimit të burimeve ujore në Gjakovë dhe Bijelo Polje" zbatuar nga kompania e furnizimit me ujë "Bistrica", BLLC Bijelo Polje në bashkëpunim me kompaninë rajonale të ujësjellësit Radoniqi Sh.A., Gjakovë në Kosovë me qëllim të përmirësimit të mbrojtjes dhe menaxhimit të burimeve natyrore të ujit në komunat e Gjakovës dhe Bijelo Polje.



This project is funded by
the European Union



MNE-KOS

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-KOSOVO 2014-2020

3. “Rritja e përfshirjes sociale përmes edukimit” zbatuar nga Qendra për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut (CEDEM) dhe Qendra për Arsim e Kosovës, synonte përforcimin e kapaciteteve të OSHC-ve që merren me komunitetet RAE për t'u angazhuar në dialogun me institucionet arsimore dhe për t'iu përgjigjur më mirë prioriteteve të përfaqësuesve të tyre në fushën e arsimit.
4. “Shfrytëzimi i inovacionit dhe ndërmarrësisë në rajonin ndërkufitar të Kosovës dhe Malit të Zi” është zbatuar nga Organizata Turistike Berane dhe STIKK – Shoqata e TIK-ut nga Kosova, me qëllim të rritjes së mirëqenies dhe mundësive për shfrytëzim më të mirë të burimeve lokale duke gjeneruar mundësi të reja biznesi dhe punësim.
5. “Valorizimi i eko-produkteve” zbatuar nga Komuna e Bijello Poles dhe Komuna e Deçanit në Kosovë, me qëllim të promovimit dhe mbështetjes së zhvillimit dhe promovimit të eko-produkteve në zonën ndërkufitare.



6. “Turizmi rural për zhvillimin ekonomik të zonës ndërkufitare të Kosovës dhe Malit të Zi” është zbatuar nga Agjencia Rajonale e Zhvillimit për Bjelasicë, Komovi dhe Prokletije dhe Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës, me objektiv kryesor promovimin e zhvillimit ekonomik të zonës së programit përmes valorizimit ekonomik të potencialeve të saj turistike dhe të qëndrueshme të bujqësisë dhe pylltarisë.
7. “Revitalizimi i komuniteteve lokale për turizëm dhe zhvillim të të rinjve” udhëhequr nga Komuna e Andrijevicës dhe zbatuar në bashkëpunim me Komunën e Junikut në Kosovë, ka nxitur zhvillimin e qëndrueshëm dhe promovimin e turizmit në komunat e Junikut (KS) dhe Andrijevicës (MZ) nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës dhe fuqizimit të të rinjve.



This project is funded by
the European Union



MNE-KOS

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-KOSOVO 2014-2020

8. “Veprim i Përbashkët për Punë të Qëndrueshme” është finalizuar nga Agjencia e Punësimit e Malit të Zi në bashkëpunim me Agjencinë për Promovimin e Punësimit nga Kosova (APPK), dhe qëllim kryesor i projektit ishte heqja e pengesave dhe ofrimi i kushteve për punësim dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në rajonin ndërkufitar, rritja e fleksibilitetit të fuqisë punëtore dhe sigurimi i cilësisë më të mirë të jetesës si dhe fuqizimin e bashkëpunimit ndërmjet akterëve të ndryshëm të tregut të punës për përfshirjen e tyre më të mirë në zhvillimin e strategjive lokale të punësimit
9. “BORN – Natyra pa kufi. Mbrojtja e biodiversitetit dhe zhvillimi i parkut natyror Prokletije dhe Bjeshkët e Nemuna” zbatuar nga Komuna e Plavës (MZ) në bashkëpunim me Trentino con il Kosovo në Kosovë, është fokusuar në përcaktimin dhe zgjerimin e njohurive të habitateve të florës dhe faunës , në rritjen e burimeve natyrore me synim ngritjen e vetëdijes në mesin e popullatës lokale mbi vlerën e mjedisit natyror.

Sesioni i tretë i konferencës përbëhej nga panele diskutimi me përfituesit e projektit të tre projekteve të zbatuara në kuadër të këtij programi dhe një përfitues final të projektit. Përkatësisht, panelistët e sesionit të tretë ishin Znj. Jelena Krivčević nga Agjencia për Zhvillim Rajonal në Bjelasicë, Komovi dhe Prokletije si përfituese dhe Znj. Marica Bučković si përfituese finale e projektit "Turizmi rural për zhvillimin ekonomik të zonës ndërkufitare të Kosovës dhe Malit të Zi", Z. Marko Bulatović nga Kompania e Ujësllësit Vodovod "Bistrica" Bijelo Polje dhe znj. Milena Bešić nga Qendra për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut (CEDEM).



Znj. Jelena Krivčević theksoi rëndësinë e projektit për zhvillimin ekonomik të zonave rurale dhe përfitimet e banorëve vendas në kuadër të zbatimit të aktiviteteve të projektit.



This project is funded by
the European Union



MNE-KOS

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-KOSOVO 2014-2020

Znj. Marica Bučković shprehu kënaqësinë e saj me rezultatet e projektit dhe shpjegoi përvojën e saj gjatë realizimit të projektit dhe qëndrueshmërinë dhe ndikimin e projektit pas përfundimit zyrtar të tij. Për më tepër, ajo ftoi përfituesit e mundshëm final/banorët lokalë të zonës së programit për të marrë pjesë në projekte të ngjashme. Ajo shpjegoi se projekti iu mundësoi atyre para së gjithash, të transformonin kompanitë e tyre bujqësore në objekte që ofrojnë shërbime të turizmit rural. Përveç kësaj, ky projekt ka zhvilluar kapacitetet e tyre në ofrimin e shërbimeve cilësore për turistët në zonën ndërkufitare përmes trajnimeve për ofrimin e shërbimeve turistike të organizuara në kuadër të projektit. Fondet e BE-së gjithashtu kanë asistuar në rindërtimin/adoptimin e hapësirave dhe shtrirjen e rrjetit të energjisë elektrike në këto zona të largëta rurale nëpërmjet ofrimit të paneleve solare për disa familje. Për më tepër, ajo i informoi pjesëmarrësit se pas përfundimit të projektit ajo kishte dërguar vizitorë në shtëpitë e tyre dhe se, në bashkëpunim me organizatën turistike lokale, tashmë ka pasur kërkesa për rezervime edhe për këtë vit.

Znj. Milena Bešić i njoftoi pjesëmarrësit rreth pengesave me të cilat ballafaqohen gjatë zbatimit dhe arritjeve në nivel të politikave lidhur me përfshirjen sociale të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, veçanërisht në arsim. Ajo theksoi rëndësinë e përfshirjes së popullatës RAE në sistemin formal të arsimit dhe lehtësimin e komunikimit mes kësaj popullate dhe institucioneve përkatëse në fushën e arsimit.

Z. Marko Bulatović prezantoi rezultatet dhe përfitimet që komunat kanë mbuluar me aktivitetet e projektit të përjetuara me futjen e GIS për matjen e konsumit të ujit dhe menaxhimin e ujit. Ai gjithashtu theksoi rëndësinë e GIS në sigurimin e qëndrueshmërisë dhe reduktimin e humbjeve të ujit në nivel lokal, veçanërisht duke pasur parasysh se deri më tani vetëm tre komunat në Mal të Zi kanë aplikuar këtë sistem.

Përfundim:

Ky modalitet i paraqitjes interaktive të arritjeve të rezultateve në kuadër të Programit IPA I të BNK-së Mali i Zi - Kosovë 2011-2013, projektet e zbatuara, si dhe përvoja specifike e përfituesve final të THP (thirrjes për propozim) të Parë brenda këtij programi kishte ndikim të ndjeshëm në rritjen e interesit të aplikantëve potencialë për t'u bërë më aktivë në hartimin e projekt propozimeve që potencialisht mund të kontribuojnë në zhvillimin socio-ekonomik.

Konferenca përfundimtare tërhoqi vëmendjen e publikut dhe mediave nga të dy anët e kufirit dhe u prezantua në lajmet qendrore të Radio Televizionit të Kosovës (RTK), në lajmet e Zërit të Amerikës (VoA) në gjuhën shqipe dhe malazeze si dhe në Radiotelevizionin Malazez (RTCG). Për më tepër, u botuan edhe një seri artikujsh në mediat online dhe të shkruara duke informuar qytetarët e të dy vendeve për këtë ngjarje.



This project is funded by
the European Union



MNE-KOS

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-KOSOVO 2014-2020

Duke ndjekur këtë fakt, pritet që raportimet e mediave të informojnë qytetarët në të dy anët e kufirit duke raportuar për aktivitetet e ndërmarra në fushën e programeve të BNK-së dhe rezultatet përkatëse, me një efekt anësor të ngritjes së nivelit të njerëzve që mbështesin integrimin e të dyja vendeve në Bashkimin Evropian. Për më tepër, rezultatet e projekteve dhe përvoja e përfituesve si dhe përfituesve final do të kontribuojnë në interesin e përgjithshëm në aktivitetet e zbatuara në kuadër të programeve të BNK-së si dhe do të rrisin interesin e aplikantëve potencialë për të aplikuar me idetë e tyre për veprime të ngjashme / të reja.

Dukshmëria e BE-së:

Gjatë Konferencës Përfundimtare flamuri i BE-së ishte i dukshëm në të gjitha slajdet e prezantimeve në power point dhe video materialet shoqëruese, me tekstin "projekti financohet nga BE". Flamuri i BE-së po ashtu ishte i shfaqur dhe i dukshëm në sallën e konferencave. Financimi i programit nga BE-ja u paraqit kudo që ishte e përshtatshme, në axhendën e konferencës, në fjalimet hyrëse, në fjalimet e Ministrit të MÇE të Malit të Zi dhe Zëvendësministrit të MAPL-së të Kosovës, dorëzimit të ftesave, nënshkrimit me e-mail, formularët e regjistrimit, listat e pjesëmarrësve, prezantimet në PowerPoint, etj.